



Republika e Shqipërisë
Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Nr. 345 prot., Tiranë, më 27.10 2020



Republika e Kosovës
Agjencia Kadastrale e Kosovës

Nr. 3117 prot., Prishtinë, më 27.10 2020



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në fushën e Infrastrukturës së të Dhënave Gjeohapësinore, duke përfshirë, Punimet themelore gjeodezike, Hartografinë, Metadatat, Standardet, Proceset dhe procedurat të fushën e gjeoinformacionit, si dhe Shkëmbimin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore nëpërmjet shërbimeve të rrjetit.

Në mes të:

**Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Republika e Shqipërisë
dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Republika e Kosovës**

Neni 1

Me anë të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Republika e Shqipërisë dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), Republika e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Nënshkruesit e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ose Palët) e vendosin interesin e përbashkët të bashkëpunimit në fushën e Infrastrukturës së të Dhënave Gjeohapësinore, duke përfshirë Punimet themelore gjeodezike, Hartografinë, Metadatat, Standardet, Proceset dhe procedurat të fushën e gjeoinformacionit, si dhe Shkëmbimin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore nëpërmjet shërbimeve të rrjetit.

Neni 2

Bashkëpunimi i nënshkruesve të Marrëveshjes në fushat e përcaktuara në Nenin 1 përfshin:

1. Shkëmbimin e informacionit mbi aktivitetet e nënshkruesve të Marrëveshjes të Bashkëpunimit (me e-mail, postë, delegacione, shkëmbim publikimesh, etj.);
2. Shkëmbimin e të dhënave të rrjeteve në përbërje të sistemeve referuese gjeodezike respektive për territoret kufitare mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës;

3. Shkëmbimin e eksperiencës në fushën e punimeve hartografike dhe shkëmbimin e të dhënave jo të klasifikuara hartografike;
4. Shkëmbimin e informacionit shkencor dhe teknik, rregulloreve, specifikimeve teknike, standardeve, proceseve dhe procedurave në fushën e gjeoinformacionit;
5. Trajnimin dhe shkëmbimin e stafit;
6. Koordinimin e pjesëmarrjes në projektet rajonale me interes të përbashkët, të financuara nga fondet e Bashkimit Evropian;
7. Harmonizimin e qëndrimeve dhe paraqitjen e përbashkët në organizatat ndërkombëtare profesionale, përmes përfaqësimit të interesave të përbashkëta të harmonizuara;
8. Organizimin e përbashkët të konferencave, punëtorive dhe promovimit ndërkombëtar të programeve të përbashkëta të bashkëpunimit;
9. Aktivitete të tjera me interes të përbashkët për të dy nënshkruesit e Marrëveshjes të Bashkëpunimit.

Neni 3

Nënshkruesit e Marrëveshjes të Bashkëpunimit do të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe do të inkurajojnë zbatimin e projekteve të përbashkëta në fushat e renditura në Nenin 1 të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, në bazë të kompetencave të tyre sipas legjislacionit kombëtar të të dy Palëve.

Neni 4

Për të monitoruar zbatimin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, për të propozuar aktivitete të reja dhe për të vënë në jetë zbatimin e tyre, nënshkruesit e Marrëveshjes së Bashkëpunimit do të takohen një herë në vit, me radhë në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.

Neni 5

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet për një periudhë pesë (5) vjeçare.

Secila palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi në çdo kohë, me një letër të dërguar Palës tjetër gjashtë muaj (6 muaj) para ndërprerjes.

Ndërprerja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nuk do të ndikojë në përfundimin e aktiviteteve të dakorduara, të filluara para datës së ndërprerjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit, përveç nëse Palët bien dakord ndryshe.

Neni 6



Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet dhe të plotësohet me pëlqim të ndërsjellë me shkrim midis Palëve.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e zbatimit të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve të përbashkëta ndërmjet Palëve.

Neni 8

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dy Palët.

Nënshkruar me datë: 23.10.2020 në TIRANË në dy (2) kopje, në gjuhën shqipe, ku dokumentet janë njësoj të besueshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

DREJTORI I PËRGJITHSHËM,


Lorenc Çala

REPUBLIKA E KOSOVËS
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

DREJTORI EKZEKUTIV,


Avni Ahmeti